

KONTRATE SHITJE**KUOTASH DHE KAPITALESH**

Në Tiranë, sot më datë 08.09.2022 (njëzetedy), midis palëve e mëposhtme lidhet kontrata e Shitjes:

- Referuar më poshtë si "**KONTRATA**"

Të nënshkruarit:

BAMI shpk ("Shoqëria"), një shoqëri Shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar rregullisht në Regjistrin Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër unik NIPT J94416206R, datë 30.09.1999, me seli ne adresën Rruga Kameras, Fushë-Krujë, përfaqësuar rregullisht nga Administratori **Z. Gëzim Bajram Marku**, shtetas Shqiptar, lindur me 03.02.1986, në Fush-Alie, banues në Durrës, mbajtës i pasaportës me numër BA2367283, me numër personal I60203009P ;

-Referuar më poshtë si "**SHITËSI**"

Dhe

Shoqëria "GLOBAL TECHNICAL MECHANICS" –shpk, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L71529026M, me adresë Rruga e Kavajës, pranë Njesisë Bashkiake nr 6, ish Kombinati i Tekstileve, Sheshi Ali Kelmendi, Godina nr 6, përfaqësuar nga Administratori Arbian Safa, atësia Pëllumb, amësia Belkiza, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në Fier, me adresë K. Permeti; Fier; 0000; Fier, lindur më 06/03/1985, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033357986 dhe nr. personal I50306087D, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

-Referuar më poshtë si "**BLERËSI**"



Referenca Ligjore: Nenet 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Neni 73,74 dhe ne teresi Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Kushte Paraprake.

1. Shoqëria “BAMI”-shpk dhe shoqëria “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” –shpk në datë 31.01.2019 kane themeluar shoqërinë tregtare “KUKËS INTERNATIONAL AIRPORT” shpk.
2. Shoqëria “BAMI”-shpk zotëron 70% të kapitalit fillestar e përbërë nga 1 (një) kuotë në shumën 7 000 000 lekë të shoqërisë “KUKËS INTERNATIONAL AIRPORT” shpk.
3. Shoqëria “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” –shpk, zotëron 30% të kapitalit fillestar e përbërë nga 1 (një) kuotë në shumën 3 000 000 lekë të shoqërisë “KUKËS INTERNATIONAL AIRPORT” shpk.

PALËT KANË RËNË DAKORD SI MË POSHTË:

NENI 1 Kushtet Paraprake.

Kushtet paraprake të mësipërme janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

NENI 2 OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është shitja e 70% (shtatëdhjetëpërqind) të kuotave të kapitalit të shoqërisë “Kukësi International Airport” shpk me NUIS L97531201R, që përfaqëson të gjitha pjesën që shitësi, shoqëria “BAMI” shpk, zotëron në shoqërinë “Kukësi International Airport” shpk.

NENI 3 ÇMIMI I SHITJES

3.1. Çmimi i Shitjes së kuotës të kapitalit të Shoqërisë “Bami” shpk do të jetë 300 000 (treqindmijë) Euro me kurs këmbimi në lekë 122 (njëqindnjëzetëdy). Pala shitëse ka rënë dakort që t’i shesë këtë kuotë palës blerëse.

3.2. Pala blerëse ka rënë dakort që ta blejë kuotën nga Pala Shitëse, kundrejt çmimit prej 300 000 (treqindmijë) Euro me kurs këmbimi në lekë 122 (njëqindnjëzetëdy).



NENI 4 MËNYRA E LIKUIDIMIT

4.1. **Palët** bien dakort që çmimi i kuotës i përcaktuar në nenin 3 të kontratës do të paguhet nga blerësi në favor të shitësit nëpërmjet sistemit bankar, në një nga llogaritë e blerësit në Bankat e Nivelit të Dytë Tiranë.

4.2. Me nënshkrimin e kontratës, Blerësit i transferohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet në raport me pjesëmarrjen e tij në Shoqëri dhe do të zoteroj 100% (njeqintperqinte) te kuotës së kapitalit te Shoqërise **“KUKËS INTERNATIONAL AIRPORT”**.

NENI 5 DETYRIMET E SHITËSIT

5.1. Shitësi do të pranojë çmimin e shitjes, të përcaktuar në nenin 3, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së kuotes, kuote e cila me nënshkrimin e kontratës i kalon bleresit.

5.2. Shitësi njofton Blerësin që kuota, objekt i kësaj kontrate është e barrësuar në favor të RFZ Banke dhe do të mbetet e tillë edhe pas transferimit të saj. Shitësi është i vetmi pronar i saj dhe gëzon të drejtën reale mbi të.

5.3. Shitësi garanton Blerësin që kuota, objekt i kësaj kontrate është e lirë nga cdo detyrim, barrë apo pretendim nga ndonje palë e tretë përveç RFZ Banke.

5.4. Shitësi garanton Blerësin që kuota, objekt i kësaj kontrate nuk është subjekt i asnjë procesi gjyqësor civil, penal, administrativ apo asnjë procesi arbitrazhi jashtë apo brenda vendi, nuk është pjesë e procedurave të ekzekutimit.

5.5. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi kuoten objekt i kësaj kontrate.

5.6. Shitësi do të marrë të gjitha masat për të garantuar përmbushjen e të gjitha detyrimeve të marra prej tij në bazë dhe për zbatim të kësaj kontrate.

NENI 6 DETYRIMET E BLERËSIT

6.1. Blerësi detyrohet të paguajë çmimin e shitjes sipas parashikimeve të përcaktuara në këtë kontratë e me konkretisht ne nenin 3 të kësaj kontrate.

6.2. Blerësi garanton Shitësin që ne datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate është njohur me gjendjen e Shoqërise **“KUKËS INTERNATIONAL AIRPORT” shpk**, nëpërmjet Pasqyrave Financiare dhe Bilancit te Shoqërise te vitit 2019-2020-2021, të deklaruar në QKB dhe në Drejtorinë Rajonale Tatimore në territor të selisë.

6.3. Blerësi merr përsipër që në momentin e fitimit të pronësisë mbi kuotën e blerë të kryej të gjithë veprimet e nevojshme dhe të nënshkruaj të gjitha aktet e kërkuara me qëllim fshirjen e shoqërise Bami shpk (shitësi) nga cilesia e zotëruesit të kuotës 70%.

6.4. Blerësi merre përsiper të mbajë te berrësuarat kuotat në favor të RFZ Banke siç kanë qënë para transferimit të saj si dhe, me regjistrimin e kësaj kontrate në QKB, merre përsipër të gjitha



detyrimet që shoqëria "BAMI" shpk në cilësinë e bashkëkredimarrësit ka ndaj RFZ Banke, sipas kontratës së kredisë bankare me RFZ Bank, Nr. 2358 rep, nr 715 kol, datë 29.03.2021.

NENI 7 INFORMIMI I BLERËSIT

7.1.Përpara nënshkrimit të kësaj marrëveshje, blerësi është njohur me gjithë dokumentacionin financiar të shoqërisë sipas deklarimeve në Drejtorinë Rajonale Tatimore në territor të selisë dhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 8 SHPENZIMET DHE TAKSAT

8.1.Shpenzimet ligjore dhe cdo lloj tjetër shpenzimi lidhur me këtë kontratë është në ngarkim të palës që i ka kryer.

8.2.Në cdo rast taksat mbi të ardhurat dhe mbi transaksionin do të paguhet nga palët respektive sipas parashikimeve të ligjit në fuqi ne territorin e Republikës së Shqipërisë.

8.3.Shpenzimet e lidhura ngushtësisht me këtë kontratë mund të jenë në ngarkim sipas përcaktimit në pikën 9.1 ose me pëlqimin e palëve mund të plotëpjestohen. Përfshihen taksat dhe tatimet e Transaksionit.

NENI 9 VLEFSHMËRIA DHE ZGJIDHJA E KONTRATËS

9.1.Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

9.2.Kjo kontratë zgjidhet:

-Në cdo kohë me marrëveshje me shkrim të palëve,

-Kur është vërtetuar me vendim të Gjykatës kompetente mospërbushja thelbësore e detyrimeve të përcaktuara në këtë kontratë.

NENI 10 PËRMBAJTJA E KONTRATËS DHE NDRYSHIMET

10.1.Kjo kontratë rregullon tërësisht marrëveshjet mes palëve dhe përmbush në mënyrë ezauruese të gjithë marrëveshjet e mëparshme me këtë objekt.

10.2.Kjo kontratë mund të ndryshohet vetëm përmes një marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga palët.

NENI 11 ORIGJINALET

Kjo kontratë është hartuar në 4(kater) kopje origjinale në gjuhën shqipe të nënshkruara nga Palët dhe në vlerë të njëjtë ligjore dhe hyn në fuqi që nga momenti i nënshkrimit të saj.Për cdo lloj



mosmarrëveshje që mund të lind në lidhje me interpretimin dhe /ose ekzekutimin e kësaj kontrate do të jenë të aplikueshme dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

NENI 12 ZGJIDHJA E MOSMARRREVËSHJEVE

Të gjithë mosmarrëveshjet mes palëve që rrjedhin, ose që në çdo mënyrë lidhen me interpretimin dhe /ose ekzekutimin e kësaj kontrate, mosmarrëveshjet të cilat nuk arrihen të zgjidhen me mirëkuptim mes palëve, do të parashtrihen për shqyrtim përfundimtar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor kompetente.

NENI 13 E DREJTA E ZBATUESHME

Kjo Kontratë si dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve në të do të rregullohen nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

NENI 14 DOKUMENTACIONI BASHKËLIDHUR KONTRATËS

Kësaj kontrate si pjesë përbërëse të saj i bashkëlidhen dokumentet si vijon:

- Vendim i Asamblesë së Ortakëve.

Kjo kontratë u lexua nga palët me zë të lartë dhe pasi u gjend në përputhje me vullnetin tyre u nënshkrua pa vërejtje.

PALA SHITËSE

BAMI-SHPK



Nr. 88

datë 08/09/22

PALA BLERËSE

“GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” –SHPK

Alision sofa
U

VENDIM
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË BAMI SHPK

Vendimi Nr.: _____

Data e mbledhjes: 25.08 2022

BAMI sh.p.k, shoqëri e së drejtës shqiptare, me seli në Tiranë, regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar me numër unik të identifikimit J94416206R, me seli në adresën Rruga e Durrësit, Tiranë, mban këtë mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

ORTAKU I VETËM I REGJISTRUAR I SHOQËRISË është:

Z.Besnik BAMI, shtetas Shqiptar, i lindur me 27.04.1971 në Krujë, Shqipëri, identifikuar me Letërnjoftim Nr.035489186 dhe Nr. Personal: H10427191E, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, qe zoteron 100% te kuotes se kapitalit te Shoqerise Bami shpk,

RENDI I DITËS :

1. Miratim të shitjes së plote te kuotave qe zoteron ne shoqerine “**KUKËS INTERNATIONAL AIRPORT” shpk**”
2. Shitja e koutave do i behet shoqerise “**GLOBAL TECHNICAL MECHANICHS**” Shpk, ortaku tjetër i shoqerise “**KUKËS INTERNATIONAL AIRPORT” shpk**”
3. Miratimi caktimit të përfaqësuesit të shoqërisë në operacionin e shitblerjes.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë konfirmon se i gjithë kapitali i Shoqërisë është i përfaqësuar dhe se janë përmbushur në përputhje me Ligjin Shqiptar dhe Statutin e Shoqërisë të gjitha kërkesat për të thirrur një Mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

PËR SA MË SIPËR, ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË:

1. VENDOSI që në përputhje me Statutin dhe Ligjin, të miratojë shitjen e kuotës që përbën 70% të kapitalit të shoqërisë **KUKËS INTERNATIONAL AIRPORT” shpk**” tek shoqëria “**GLOBAL TECHNICAL MECHANICHS**” Shpk, një shoqëri Shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar me Nr.NUIS L71529026M, me seli ne Tiranë, Rruga e Kavajës, pranë Njësisë Bashkiake nr 6, ish Kombinati i Tekstileve, përfaqësuar nga Ortaku i Vetem i saj z. Ridgers MEMA, lindur më datë 03.12.1992, identifikuar me pasaporten Nr. BB7246410 dhe Nr.personal J21203062A, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Për këtë arsye do të lidhet dhe kontrata përkatëse mes palëve

2. VENDOSI të autorizojnë z. **Gezim Bajram Marku**, shtetas Shqiptar, lindur me 03.02.1986, ne Fush Alie, banues ne Durrës, mbajtes i pasaportes me numer BÇ2367283, me numër personal I60203009P për të veprua, në këtë operacion duke i dhënë të drejta të plota të përfaqësimit dhe firmës së shoqërisë BAMI-shpk në procedurat e lidhjes dhe nënshkrimit të kontratës së shit-blerjes si më sipër, si dhe të ndërmarrë çdo veprim të nevojshëm për të bere efektiv këtë vendim përpara çdo autoriteti shtetëror, sipas kërkesave të ligjit.

NË DËSHMI TË SA ME SIPËR , Ortaku i Vetëm i Shoqërisë Besnik BAMI, përfaqësues i 100 % të kapitalit të Shoqërisë, me vullnetin e tij te lirë e të plotë nënshkruan këtë dokument.

Ortaku
BAMI SHPK



Administratori
Gëzim Marku



VENDIM
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË GLOBAL TECHNICAL MECHANICHS SHPK

Vendimi Nr.: _____

Data e mbledhjes: 25.08 2022

“GLOBAL TECHNICAL MECHANICHS” Shpk, një shoqëri Shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar me Nr.NUIS L71529026M, me seli ne Tiranë, Rruga e Kavajës, pranë Njesisë Bashkiake nr 6, ish Kombinati i Tekstileve, mban këtë mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

ORTAKU I VETËM I REGJISTRUAR I SHOQËRISË është:

Z. Ridgers MEMA, lindur më datë 03.12.1992, identifikuar me pasaporten Nr. BB7246410 dhe Nr.personal J21203062A, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, qe zoteron 100% te kuotes se kapitalit te Shoqerise .

RENDI I DITËS :

1. Miratim blerjes te kuotave qe zoteron shoqeria “BAMI” shpk ne shoqerine “**KUKËS INTERNATIONAL AIRPORT” shpk**”
2. Miratimi caktimit të përfaqësuesit të shoqërisë në operacionin e shitblerjes.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë konfirmon se i gjithë kapitali i Shoqërisë është i përfaqësuar dhe se janë përmbushur në përputhje me Ligjin Shqiptar dhe Statutin e Shoqërisë të gjitha kërkesat për të thirrur një Mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

PËR SA MË SIPËR, ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË:

1. VENDOSI që në përputhje me Statutin dhe Ligjin, të miratojë blerjen e kuotës qe zoteron shoqeria “BAMI” shpk ne shoqerine “**KUKËS INTERNATIONAL AIRPORT” shpk**” dhe qe perben 70% te kapitalit te shoqerise “**KUKËS INTERNATIONAL AIRPORT” shpk** . Për këtë arsye do të lidhet dhe kontrata përkatëse mes palëve

2. VENDOSI të autorizojnë z. Arbian Safa, atësia Pëllumb, amësia Belkiza, shtetas Shqiptar, lindur në Fier me 06.03.1985 dhe banues në Fier, me adresë K. Permeti; Fier; 0000; Fier, mbajtes i Leternjoftim ID nr. 033357986 dhe nr. personal I50306087D, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar në këtë operacion duke i dhënë të drejta të plota të përfaqësimit dhe firmës së shoqërisë **GLOBAL TECHNICAL MECHANICHS** -shpk në procedurat e lidhjes dhe nënshkrimit të kontratës së shit-blerjes si më sipër, si dhe të ndërmarrë çdo veprim të nevojshëm për të bere efektiv këtë vendim përpara çdo autoriteti shtetëror, sipas kërkesave të ligjit.

NË DËSHMI TË SA ME SIPËR , Ortaku i Vetëm i Shoqërisë Ridgers MEMA, përfaqësues i 100 % të kapitalit të Shoqërisë, me vullnetin e tij te lirë e të plotë nënshkruan këtë dokument.

Ortaku
GLOBAL TECHNICAL MECHANICHS SHPK

Ridgers Memë

